

MBI
AUDITIMIN E BRENDSTEM
USHTRUAR NE TEATRIN "MIGJENI"

Njesia e Auditimit te Brendshem - Bashkia Shkoder bazuar në ligjin 114/2015 "Per Auditimin e Brendshem ne sektorin publik"; V.K.M Nr. 212 dt 30.3.2012 "Per miratimin e kriterëve per ngritjen e njesive te auditimit te Brendshem ne Sektorin Publik", zhvilloi nje mision auditimit te plote Teatrin "Migjeni" për periudhën 01.01.2013 deri me 31.12.2015 dhe nga auditimi i kryer rezultoi:

Permbledhje ekzekutive

Teatrit "Migjeni nuk ka nje rregullore te miratuar, nuk ka sistem te kontrollit te brendshem, nuk ka te percaktuar objektivat, ka konflikt ne vendimmarrje, nuk eshte ngritur sisitemi i monitorimit. Mungon rregullorja e brendshme sipas ligjit te menaxhimit financiar, planifikimi i buxhetit nuk eshte bazuar ne objektivat e institucionit. Ka mangesi ne menaxhimin e burimeve njerzore, si ne prezencen ne punë, dokuemntimin e punes dhe mosperputhje te kualifikimit me punen qe kryejne. Ka mangesi ne vlersimin paraprak te aktiviteve kulturore, jane rekrutuar personel i jashtem pa kualifikimin e duhur si dhe pa kontrate sherbimi, niveli i te ardhurave ne aktivitetet kulturore ka qene ne nivele shume te ulta. Ka mangesi ne ndjekjen e procedurave te prokurimeve publike, procedura likuiduese e aktivitetve kulturore nuk ndjek nje linj te rregullt qe nga perpilimi i projektit, procedura tenderuese, kontraktuese, miratuese nga titullaret dhe likuidimi. Ka mangesi ne kryerjene regjistrimeve kontabile,ka mangesi ne perpilimin e rregullores dhe menaxhimin e asetëve.

GJETJET DHE REKOMANDIMET

Gjetje nr. 01: Teatri "Migjeni", ka mangësi në perpilimin dhe miratimin e rregullores së brendshme, nuk ka të përcaktuar funksionimin e kontrollit të brendshëm, ka mangësi në regjistrimin e operacioneve, ka mangësi në administrimin e vlerave materiale, nuk ka përcaktuar objektivat, nuk ka përpiluar regjistër rrisht

Rekomandim nr. 01 Përshtatjen e rregullores se brendshme ne perputhje me ligjin nr. 10296 date 08.07. 2010"Per menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, detajimin ne menyre analitike te te gjithë aktiviteve qe kryen cdo punonjes, detajimin e sistemit kontrollit sipas aktiviteve, miratimin e rregullores nga Kryetari i Bashkisë. (sipas modelit rastit studimor nr. 03 të manualit menaxhimit financiar dhe kontrollit).

Rekomandim nr. 02: Përcaktimin e objektiveve te institucionit, vleresimin e mundesise së ndodhjes se ngjarjeve, *si dhe perpilimin e regjistrit te rrishtit*, sipas modelit rastit studimor nr. 04 të manualit menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Gjetja nr. 02: Drejtimi ka mangësi ne përcaktimin e objektiveve, ne kryerjen e funksioneve të ngarkuara, ne rritjen e efektivitetit te aktiviteve, ne rritjen e te ardhurave, ne regjistrimin ne operacioneve

Rekomandim nr.03: Ngritjen dhe funksionimin e sistemit te informimit dhe monitorimit, si dhe kryerjen e dokumentimit, për të bërë të mundur evidentimin në kohë të problematikave me qëllim përmirësimin e efencës se institucionit.

Gjetje nr. 03: Ka mangesi ne mbajtjen e dosjeve te personelit, nuk eshte bërë vlersim i punës së punonjësve, nuk respektohet prezenca në punë, nuk jane lidhur kontrata me punëmarresin, duke vepruar ne kundërshtim me nenin 12 te ligjit nr. 9761 date 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, nuk janë përcaktuar detyrat funksionale të punonjësve, nuk janë përcaktuar dhe ndjekur fushat me rrisht të lartë:

Rekomandim nr. 04: Rishikimin e kontrates se punës me punonjesit qe nuk respektojne marrdheniet kontraktuale.

Rekomandim nr. 05: Lidhjen e kontratës se punës për të gjithë personelin, përcaktimin e detyrave funksionale të punonjësve, përcaktimin dhe ndjekjen e fushave me rrisht të lartë.

Rekomandim nr. 06: Plotësimin e dosjeve te punonjesve, kryerjen e vlersimit te punes se punonjesve

Gjetja nr. 04 Planifikimi i buxhetit nuk është bërë bazuar ne realizimin e objektivave, nuk jane paraqitur projekte që do të realizohen për vitin në vazhdim.

Nuk ka gjetur zbatim pika 263 i udhëzimit nr. 02 date 06.02.2012 “Për procedurat standarte te zbatimit te buxhetit” i ndryshuar

Rekomandim nr. 07: Planifikimi i buxhetit te behet bazuar ne objektivat i ndarë sipas aktiviteteve. Aktivitetet artistike te planifikohen mbi bazen e konkurimit te projekteve.

Rekomandim nr. 08: Te kerkohet asistence prane Bashkise per perpilimin e gjurmes auditit për buxhetin

Gjetje nr. 05: Buxhetimi nuk është bërë sipas objektivave e programeve, nuk disponohet rregullore e ruajtjes së aseteve, nuk është dokumentuar, vlersimi i punës se punonjësve.

Gjetje nr. 06: Nuk është bërë rakordim lidhur me mbledhjen dhe arketimin e të ardhurave, si dhe është dhënë në përdorim salla e Teatrit “Migjeni, duke vepruar në kundërshtim me nenin 8 të ligjit nr. 8652 datë 31.07.2000 “Për Organizimin e funksionimin e Qeverisjes Vendore” i ndryshuar, neni 9 i ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”

Rekomandim nr. 09: Buxhetimi të bëhet bazuar ne programeve dhe aktiviteteve

Rekomandim nr. 10: Per dhenien në përdorim të ambjenteve të Teatrit “Migjeni” të bëhet një studim paraprak, ku të përcaktohet periudha kur mund të përdoret nga të tretë. Per dhenien në përdorim t'i propozohet, Kryetares Bashkisë e njekohesisht Këshillit Bashkiak për lejimin e perdorimit nga të tretët i ambjenteve të Teatrit, përcaktimin e fushes përdorimit, përcaktimin e tarifave orare.

Gjetja nr. 07: Janë kryer pagesa për vlerë 137.716 lek, per 2 punonjes, në kundërshtim me lidhjen 6 të V.K.M. nr. 518 datë 16.08.2012 “Për disa ndryshime në V.K.M nr. 1619 date 02.07.2008 “Per klasifikimin e funksioneve, grupimin e njesive te qeverisjes vendore per efekt page dhe caktimin e kufinjeve te pagave te punonjesve te organeve qeverisjes vendore”

Gjetja nr. 08: Nuk është mbajtur regjistri i pagave duke vepruar ne kundërshtim me piken 2 te V.k.M nr. 594 date 22.12.1997 “Per regjistrin që mban punëdhënesi për punemarresin e tij”.

Rekomandim nr. 11: Të bëhet ndalesa për vlerë 137.716 lek për dy punonjës, si dhe të verifikohen pagesat e kryera jashte periudhes se auditimit. Pagesat ne cdo rast te behen ne baze te list prezences.

Gjetja nr.09 kerkesa per prokurim’ nuk eshte bere nga drejtuesi funksional shpenzimit dhe nuk i është drejtuar nënpunesit autorizues, veprim që bie në kundërshtim me nenet 140-142 Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.02 datë 06.02.2012”Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”. rastet e blerjeve me vlere nen 100.000 lek planifikimi I shpenzimit, kryerja e procedures se prokurimit dhe nenshkrimi I kontrates ose fatures është vepruar ne kundërshtim me piken 4,8 Udhëzimin nr 3 date 27.01.2015“Prokurimi me vlere te vogla”,si dhe pika 3,4,7 neni 2 neni 40 te VKM nr 914 date 29.12.2014”Rregullat e prokurimit Publik”. Në të katër rastet është vepruar me protokoll të brendshëm të prokurimeve dhe dokumentacioni nuk është protokulluar pranë sekretarisë së Bashkisë. mungon gjurma e auditit në kundërshtim me pikën 19/neni 4 ligjit 10296 datë 8.07.2011“Menaxhimit Financiar” dhe Urdhërit nr 57 datë 12.06.2014 të Ministrisë së Financave”Për gjurmën e auditit për blerjet me vlere të vogla”.

Rekomandimi nr. 12: Te behet kualifikimi i personelit per procedurat e prokurimeve publike, si dhe ne pamundesi te kryerjes se procedurave, sipas kerkesave te ligjit prokurimeve te kerkohet Bashkise Shkoder per te dhene asistencen e nevojshme.

Gjetje nr. 10: Janë organizuar aktivitete kulturore artistike, pa ndjekur procedurat paraprake te konkurimit te projekteve, nuk është bërë dokumentimi ligjor i vlersimit të projekteve artistike, kanë përfituar shpërbllim antarët e bordit pa u bazuar në dispozita ligjore apo vendim të këshillit Bashkiak.

Rekomandim nr. 13: Riorganizimin e bordit artistik ne nivel vendor, me kompetence vlersimin e te gjitha ngjarjeve kulturore e artistike në Bashkinë Shkodër, rindertimin e statutit dhe rregullores.

Rekomandim nr. 14: Të bëhet ndalesa për vlerë 249.000 lek për pese antaret e bordit kultures.

Gjetja nr. 11: Ka mangesi ne regjistrimin e veprimeve kontabile nuk është bërë inventarizimi i pasurise, nuk është përpiluar rregullorja e asetëve, nuk është bërë ndertimi i planit per mirmbajtjen e asetëve.

Rekomandim nr. 15: Instruktimin e personelit prane Bashkise Shkoder per regjistrimet kontabile dokumentimin e pasurise, ndertimin e planit per mirmbajtjen e asetëve dhe per përpilimin rregullores asetëve

